VENDIM
Nr. 33, datë 17.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 17.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (Gj) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GJON SHKAMBI, përfaqësuar nga avokati Gjetan Gjetani, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-975, datë 18.3.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave për çështjen nr. 11216-01487-00-2018 regjistri, datë 3.5.2018, në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 124, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, pretendimet e kërkuesit Gjon Shkambi *(kërkuesi),* i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është pronar i një sipërfaqeje toke të fituar me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave *(KKKP)*, Shkodër. Sipas tij, kjo sipërfaqe ka qenë pjesërisht e zënë me objekte, si dhe pjesërisht e lirë dhe në lidhje me të, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, ka ushtruar pa pengesë të drejtën e parablerjes.

2. Në kushtet kur vendimi i KKKP-së kishte pasaktësi, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi për saktësimin e tij. Me vendimin nr. 119, datë 11.2.2002, kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke saktësuar vendimin e KKKP-së. Në vijim, me vendimin nr. 20, datë 28.6.2010 *(vendim nr. 20/2010)*, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

3. Në kushtet kur objekti në sipërfaqen e pronës së kërkuesit, konkretisht ish-Shkolla e Rezervave, Shkodër, ishte zënë nga posedues të paligjshëm, ai i është drejtuar përmbaruesit gjyqësor M.T. për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Bazuar në kërkesën e kërkuesit dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër nr. 20/2010, përmbaruesi gjyqësor M.T. u është drejtuar individëve

që jetonin në pasurinë e kërkuesit për lirimin vullnetarisht të banesave dhe ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv.

4. Në vijim, një grup banorësh të godinës së ish-Shkollës së Rezervave, Shkodër, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, vendimit nr. 34 prot., datë 21.1.2013 të përmbaruesit gjyqësor. Po kështu, një pjesë e tyre kanë paraqitur edhe kërkesë për sigurimin e padisë dhe pezullimin e këtyre veprimeve përmbarimore.

5. Me vendimin nr. 11, datë 7.2.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur sigurimin e padisë për një afat 6-mujor, duke pezulluar veprimet përmbarimore kundrejt pagesës së garancisë prej 20.000 lekësh në muaj secili kërkues për këtë afat. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga kërkuesi dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 52, datë 10.6.2013, ka vendosur lënien e tij në fuqi.

6. Po kështu, edhe disa nga të padituri e tjerë në proces i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë për sigurimin e padisë dhe pezullimin e veprimeve përmbarimore deri në përfundim të procesit gjyqësor. Me vendimin nr. 16, datë 21.2.2013, kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesës dhe sigurimin e padisë për një afat 6-mujor, duke pezulluar veprimet përmbarimore në emër të tyre kundrejt pagesës së garancisë prej 20.000 lekësh në muaj secili kërkues për këtë afat në shumën totale 360.000 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 56, datë 20.6.2013, ka vendosur lënien në fuqi të tij.

7. Ndërkohë lidhur me themelin e çështjes, me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 778, datë 27.3.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesës dhe heqjen e masës së sigurimit të padisë për pezullimin e veprimeve përmbarimore dhënë me vendimet nr. 11, datë 7.2.2013 dhe nr. 16, datë 21.2.2013 të kësaj gjykate. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 1073, datë 12.6.2014, ka vendosur lënien në fuqi të tij. Nga verifikimi në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë rezulton se me vendimin nr. 00-2023-4208, datë 25.10.2023, kjo gjykatë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1073, datë 12.6.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

8. Në datë 26.6.2014 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me padi për detyrimin e të paditurve ta dëmshpërblejnë në vlerën e qerasë 20.000 lekë secili i paditur që nga dita 7.2.2013, kur është bërë kërkesa për sigurimin e padisë, deri ditën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës, bllokimin e shumës që i përket vendimit nr. 11, datë 7.2.2013, si dhe bllokimin e shumës 360.000 lekë që i përket vendimit nr. 16, datë 21.2.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në përfundim të gjykimit, kjo gjykatë, me vendimin nr. 809, datë 25.5.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

9. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 766, datë 6.11.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër vendimit kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, çështje e cila është regjistruar me nr. 11216-01487-00-2018, datë 3.5.2018.

10. Në pritje të shqyrtimit të çështjes së tij, në datën 10.2.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-975, datë 18.3.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se edhe pse çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja "d", të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*, vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete objekt gjykimi është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Sipas atij kolegji, mosveprimi i Gjykatës së Lartë nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar edhe kritere transparente për marrjen sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë caktuar në cilësinë e gjyqtarit relator. Në përfundim,

Kolegji Civil ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme nga gjyqtari relator.

11. Në datën 25.8.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 29.10.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtim të:

12.1. *Standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm,* për shkak se çështja e kërkuesit edhe pse është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 3.5.2018 nuk është gjykuar ende, në kundërshtim me afatin për gjykimin e çështjeve në atë gjykatë, që është dy vjet sipas nenit 399 të KPC-së. Kjo çështje, megjithëse ka shumë palë të paditura, nuk është komplekse, dhe ai nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të gjykimit, pra nuk është bërë shkak për vonesat. Çështja në pritje të gjykimit ka rëndësi të veçantë, pasi ka për objekt të drejta që rrjedhin nga prona, për të cilën janë zhvilluar një sërë procesesh që nga viti 1993 për ta marrë në posedim.

12.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe e paanshme,* pasi Kolegji Penal i referohet në mënyrë të gabuar nenit 399/2, pika 3, të KPC-së, sipas të cilit nuk konsiderohet shkelje e afatit të arsyeshëm kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive në procedim.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor, në kuadër të të cilit ka pretenduar se i është cenuar e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

15. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pasi ka përdorur mjetin juridik parandalues/përshpejtues të parashikuar nga KPC-ja. Ai i është drejtuar më parë Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe përshpejtimin e gjykimit, në zbatim të neneve 399/5 dhe 399/6, pika 1, shkronja "c", të KPC-së, për të cilën ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ankohet për kohëzgjatjen e gjykimit në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, por edhe për mungesën e efektivitetit të mjeteve të parashikuara nga KPC-ja për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

16. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pranuar se neni 13 i KEDNJ-së i lejon një shteti të zgjedhë midis një mjeti "parandalues ose përshpejtues", të projektuar për të përshpejtuar procedurat, në mënyrë që të parandalojë që ato të tejzgjasin dhe një mjeti "riparues,

kompensues ose monetar", që parashikon korrigjimin *ex post facto* për vonesat që kanë ndodhur tashmë, qoftë edhe nëse procedura është ende në shqyrtim. Ligjvënësi shqiptar ka parashikuar një zgjidhje të kombinuar përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së. Ky mekanizëm është vlerësuar, në parim, si efikas edhe nga GJEDNJ-ja, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës të individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur *(shih vendimet nr. 75, datë 20.11.2025; nr. 58, datë 17.9.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka përdorur mjetin parandalues/përshpejtues, por kërkesa e tij është rrëzuar me vendimin e datës 18.3.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se tejzgjatja e gjykimit të çështjes ka ndodhur për shkaqe objektive të pavarura nga vullneti i gjyqtarit relator. Edhe aktualisht rezulton se ende nuk ka një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj nga Kolegji Civil i asaj gjykate. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mjetet juridike nuk kanë qenë efektive për përshpejtimin e procedurave dhe kërkuesi nuk ka më mjete juridike efektive në dispozicion, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis,* në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i Gjykatës së Lartë objekt ankimi, referuar informacionit të marrë në rrugë elektronike nga ajo gjykatë, është bërë i disponueshëm për palët në datën 27.5.2025, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 25.8.2025, brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka ngritur pretendime për cenimin *e së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *kohëzgjatjes së paarsyeshme* të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, si dhe në drejtim të *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vëren se ai është në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore, i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

20. Kërkuesi ka pretenduar se çështja e tij edhe pse është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 3.5.2018 nuk është gjykuar ende, në kundërshtim me afatin për gjykimin e çështjeve në atë gjykatë, që është dy vjet sipas nenit 399 të KPC-së. Sipas kërkuesit, kjo çështje, megjithëse ka shumë palë të paditura, nuk është komplekse, si dhe ai nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për shtyrje të gjykimit, pra nuk është bërë shkak për vonesat. Çështja në pritje të gjykimit ka rëndësi të veçantë, pasi ka për objekt të drejta të cilat rrjedhin nga prona, për të cilën janë zhvilluar një sërë procesesh që nga viti 1993 për ta marrë në posedim.

21. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Në rastin konkret Gjykata vëren se çështja e kërkuesit është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 3.5.2018, me numër 11216-01487-00-2018, mbi bazën e rekursit të tij dhe lidhet me një mosmarrëveshje që rrjedh nga e drejta e pronës dhe ndonëse aktualisht kanë kaluar 7 vjet e 4 muaj që prej datës së regjistrimit, referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë në ditën e vendimmarrjes, rezulton se ende nuk ka një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj nga Kolegji Civil i asaj gjykate. Po kështu, sipas informacionit të datës 5.3.2026, të dërguar prej Gjykatës së

Lartë përmes postës elektronike, rezulton se çështja e kërkuesit: "*ndodhet ende në fazë studimi dhe aktualisht nuk ka një datë të planifikuar nga Kolegji Civil i kësaj gjykate*". Për rrjedhojë, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuesit ka tejkaluar afatin 2-vjeçar, që sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së është parashikuar si afat i arsyeshëm për gjykimin civil në Gjykatën e Lartë. Gjykata vëren, gjithashtu, se kohëzgjatja tërësore e procesit gjyqësor deri në këtë fazë të tij është afërsisht 12 vjet, referuar datës së regjistrimit të padisë në gjykatën e shkallës së parë (data 28.6.2014).

23. Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kritereve: i. sjellja e kërkuesit; ii. kompleksiteti i çështjes; iii. sjellja e autoriteteve; iv. rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. Në lidhje me këto kritere, në përfundim të diskutimeve, vlerësimet e gjyqtarëve u ndanë në dy qëndrime dhe Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të Ligjit Organik të saj.

25. Sipas *njërit qëndrim,* për sa u përket kritereve që kanë të bëjnë me sjelljen e kërkuesit, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, bazuar në qëndrimin e konsoliduar të Gjykatës për vlerësimin e tyre *(shih vendimet nr. 29, datë 10.3.2026; nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.9.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*, konstatohet se ato nuk kanë përbërë shkak për tejzgjatjen e afatit të gjykimit të çështjes. Për më tepër, një fakt i tillë është vërejtur edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin objekt kundërshtimi, e cila ka pranuar se vonesa nuk ka ardhur si pasojë e kërkesave të palëve ose kompleksitetit të natyrës së çështjes. Për rrjedhojë, për të vlerësuar pretendimin e kërkuesit, në rastin konkret duhet ndalur vetëm në analizën e kriterit të *asaj se çfarë rrezikon ai* për shkak të vonesave në gjykimin e çështjes së tij në raport me kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjes[1].

26. Konkretisht, çështja gjyqësore e kërkuesit ka të bëjë me detyrimin e palëve të paditura, në cilësinë e poseduesve të një objekti në pronësi të kërkuesit, për ta dëmshpërblyer atë me vlerën e qirasë dhe ndonëse kanë kaluar 12 vjet në pritje të zgjidhjes së saj, ende gjykatat nuk kanë disponuar një vendimmarrje përfundimtare. Kjo çështje, për nga natyra e saj, edhe pse nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa "*jetësorë*", që kërkojnë trajtim me përparësi, lidhet me të drejtën e pronës, konkretisht me vlerën e përdorimit të saj si një nga tagrat e pronësisë. Në rastin kur çështja gjyqësore ka në objektin e saj të drejtën e pronës private, Gjykata ka pohuar se përfshihet në listën e çështjeve me interes të rëndësishëm, pasi prona private përbën jo vetëm të drejtë themelore, por edhe një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit *(shih vendimet nr. 2, datë 21.1.2025; nr. 1, datë 6.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese)*. Sipas Gjykatës, rëndësia e së drejtës kushtetuese të pronës private, nga e cila rrjedh edhe e drejta për ta gëzuar e disponuar atë, ka rëndësi në drejtim të asaj që rrezikon paditësi për shkak të tejzgjatjes së procedurave gjyqësore *(shih vendimin nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*. Duke mbajtur në konsideratë këto standarde, Gjykata në jurisprudencën e saj, ka konstatuar shkelje të afatit të arsyeshëm në çështje të cilat kanë në objekt mosmarrëveshje që lidhen me të drejtën e pronës *(shih vendimet nr. 30, datë 10.3.2026; nr. 75, datë 20.11.2025; nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Për sa më lart, në referim të jurisprudencës kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe të rëndësisë që ka ushtrimi i së drejtës së pronës në përmbushjen e interesave jetësorë të individit, konstatohet se kohëzgjatja tërësore prej 12 vjetësh e procesit gjyqësor të nisur nga kërkuesi përbën një periudhë relativisht të gjatë që nuk përmbush kriterin e "afatit të arsyeshëm". Kjo periudhë e mosveprimit në rastin konkret, e justifikuar vetëm me arsye të natyrës së përgjithshme, si reforma në sistemin e drejtësisë dhe ngarkesa e gjyqtarëve, nuk përbën argument kushtetues për të përligjur

[1] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Genti Ibrahimi dhe Marjana Semini.

një vonesë të tillë. Po kështu, kjo kohëzgjatje, *per se*, është tregues i mjaftueshëm se procesi gjyqësor në rastin konkret nuk ka respektuar garancitë kushtetuese dhe ligjore për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe efektiv. Në këto kushte, rezulton se gjykatat e zakonshme kanë dështuar të sigurojnë dhënien e drejtësisë pa vonesa, ndërkohë që mosmarrëveshja në fjalë ka mbetur në pritje për një periudhë të tejzgjatur. Si rrjedhojë, nisur nga rrethanat e rastit në shqyrtim, kohëzgjatja prej 12 vjetësh përbënte shkak të mjaftueshëm që Gjykata e Lartë të konstatonte cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, prandaj pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është i bazuar.

28. Sipas *qëndrimit tjetër,* shkak determinant për kohëzgjatjen e gjykimit janë bërë kompleksiteti i çështjes dhe sjellja e kërkuesit.[2]

29. Për sa i takon kompleksitetit të çështjes, ashtu siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Çështja e kërkuesit ka natyrë civile, dhe lidhet me të drejtën e pronësisë. Konkretisht, kërkuesi ka fituar të drejtën e pronësisë sipas ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave për një ndërtesë në qytetin e Shkodrës, në të cilën banonin shumë familje. Këto të fundit kishin të drejtën e banimit me anë të vendimit të Këshillit Bashkiak të vitit 1992, për shkak të statusit "të pastrehë". Kërkuesi i është drejtuar gjykatave të zakonshme për të urdhëruar ekzekutimin e detyrueshëm të titullit të tij të pronësisë, por gjatë procedurave përmbarimore ka pasur disa konflikte gjyqësore për kundërshtimin e tyre me rezultate të ndryshme gjyqësore. Ndër të tjera, kërkuesi ka paditur 22 prej banorëve, duke kërkuar të drejtën e shpërblimit në vlerën 20.000 (njëzet mijë) lekë në muaj nga data 7.2.2013, si dhe bllokimin e shumave monetare si garanci nga banorët për të cilat ishte disponuar me dy vendime të tjera gjyqësore të datave 7.2.2013 dhe 21.2.2013. Nga këto të dhëna është e qartë që çështja paraqitet komplekse, në drejtim të palëve, ligjit të zbatueshëm, numrit të konsiderueshëm të çështjeve gjyqësore të hapura dhe provave.

30. *Për sjelljen e kërkuesit*, Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se vlerësimi i sjelljes është element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Mbi bazën e këtij standardi vlerësohet se sjellja e kërkuesit ka qenë shkak për zvarritjen e gjykimit në disa drejtime, që përfshijnë një strategji mbrojtjeje të tillë që ka ndikuar në ecurinë e procesit. Hapja e një numri të konsiderueshëm procesesh gjyqësore për ekzekutimin e vendimeve është një faktor që duhet konsideruar, veçanërisht në kontekstin ku gjatë gjykimit të një prej këtyre çështjeve ka ndodhur edhe vrasja e një gjyqtari në sallën e gjyqit. Po ashtu, rezulton se me anë të proceseve gjyqësore është tentuar të risillen në fuqi efekte të zgjidhura më parë nga gjykatat. Kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e datës 27.3.2013, kishte vendosur heqjen e masës së sigurimit të padisë për pezullimin e veprimeve përmbarimore të dhënë me vendimet e datave 7.2.2013 dhe 21.2.2013 të kësaj gjykate, pra duke hequr detyrimin e banorëve për pagimin e garancisë. Pavarësisht kësaj, kërkuesi i është drejtuar sërish gjykatës me çështjen konkrete, duke kërkuar të risillte në fuqi vendimet për detyrimin e garancisë.

31. Për sa më lart, duke vlerësuar dy faktorët e mësipërm, të cilët janë bërë shkak determinant për ecurinë e procesit, analiza e kritereve të tjera bëhet e panevojshme, ndaj kërkesa për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm është e pabazuar.

---

[2] Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Ilir Toska dhe Asim Vokshi.

32. Në përfundim, Gjykata çmon se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa e kërkuesit konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", 133, pika 2, shkronja "i" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.3.2026.
Shpallur më 8.5.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Asim Vokshi